VENDIM
Nr. 158, datë 16.11.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË "CEZ SHPËRNDARJE" SHA, PËR AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 8, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR DHE PËR AKTIVITETIN E FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 9, DATË 25.1.2008, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa "a", 9 dhe 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 5, 6, 7 dhe 8 të rregullores "Për heqjen e licencave", miratuar me vendimin nr. 68, datë 4.11.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; licencës "Për aktivitetin e furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 9, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar, licencës "Për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin nr. 8, datë 25.1.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, të ndryshuar; kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë dhe jofamiljarë, miratuar me vendimet nr. 108 dhe nr. 109, datë 21.10.2011 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s; kontratës së furnizimit me energji elektrike me KESH sh.a. dhe "CEZ shpërndarje"; marrëveshjes së transmetimit mes OST sh.a. dhe "CEZ Shpërndarje" dhe nenit 18 pika 1 germa "a" të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2012, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike për heqjen e licencës së shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqje të licencave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike shoqërisë "CEZ Shpërndarje" sh.a.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë "CEZ Shpërndarje" për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
3. "CEZ Shpërndarje" ka të drejtën për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, në bazë të nenit 18 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe nenit 8 të "Rregullores së heqjes së licencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani